

# Çfarë parasheh baza e re ligjore e pushtetit lokal në Kosovë?



Çfarë parasheh baza e re ligjore  
e pushtetit lokal në Kosovë?

Gusht 2022

— **Përmbajtja**

Përmbledhje ekzekutive	3
Hyrje	4
1. Ndryshimet e propozuara në Ligjin për vetëqeverisje lokale	5
2. Ndryshimet e propozuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal	6
3. Përfitimet dhe obligimet komunave nga Ligji për menaxhimin e performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë	12
Përfundim	16

## Përmbledhje ekzekutive

Dy vitet e fundit (2021–2022), Qeveria e Kosovës ka paraqitur agjenda legjislative të cilat përmbajnë një numër të madh të projektligjeve të reja ose ndryshimplotësime të ligjeve ekzistuese. Këtu bëjnë pjesë edhe tri projektligje që rregullojnë pushtetin lokal, siç është Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për vetëqeverisje lokale, Projektligji për financat e pushtetit lokal, dhe Projektligji për menaxhimin e performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë.<sup>1</sup>

Deri në fund të muajit korrik 2022, vetëm Projektligji për menaxhimin e performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, ka marrë miratimin e plotë në Kuvendin e Kosovës. Projektligji për vetëqeverisje lokale ka kaluar leximin e parë në Kuvend, ndërsa Projektligji për financat e pushtetit lokal nuk është miratuar ende as nga Qeveria, ndonëse për të janë përmblytur procedurat e konsultimit publik në shtator të vitit 2021.

Në bazë të propozimeve të përfshira në këto tri projektligje, sistemi i qeverisjes lokale do të ketë disa ndryshime përmbajtësore. Me Projektligjin e financave të pushtetit lokal, komunat do të kenë edhe tri grante të reja, atë për projekte kapitale, për shërbime sociale dhe grantin e jashtëzakonshëm. Për grantin për shërbime sociale dhe atë të jashtëzakonshëm nuk janë paraparë vlerat financiare që komunat do të përfitojnë, por janë vendosur kriteret për mënyrën se si do të ndahen grantet. Vlerat financiare do të vendosen me akte nënligjore.

"Granti i katërt për komuna", i cili ishte premtim elektoral, është ri-emëruar si grant për projekte kapitale. Ndarja e këtij granti do të jetë graduale. Në vitin e parë pas hyrjes në fuqi të ligjit, ndarja do të jetë në vlerën 20%, në vitin e dytë 30%, ndërsa nga viti i tretë minimum 40% të vlerës së grantit të përgjithshëm. Nga kjo i bie që komunat që nga viti i parë përfitojnë mbi 45 milionë euro dedikuar për investime kapitale, ndërsa nga viti i tretë, vlera e këtij granti do të jetë jo më pak se 104 milionë euro. Granti për projekte kapitale do të ndahet 80% bazuar në numrin e popullsisë së komunës dhe 20% bazuar në gjerësinë gjeografike. Nisur nga kjo, komunat që do të përfitojnë më së shumti do të jenë Prishtina, Prizreni, Podujeva, Peja, Ferizaj, Gjlani, Gjakova, Mitrovica e Jugut dhe Rahoveci, ngase madhësia e territorit dhe numri i popullsisë u mundëson këtyre komunave të kenë më shumë buxhet nga granti për projekte kapitale. Me hyrjen në fuqi të rregullave të reja të parapara në Projektligjin për financat e pushtetit lokal dhe fillimit të zbatimit të grantit për projekte kapitale, ministrinë nuk mund të investojnë në projekte kapitale në komuna.

Përveç këtyre granteve, është paraparë edhe granti i performancës komunale. Vlera e këtij granti do të jetë 2.5% e vlerës së grantit të përgjithshëm, ose për çdo vit do të ndahen mbi pesë milionë euro për të mbështetur projekte kapitale për komunat që vlerësohen lartë për performancën e tyre. Përveç buxhetit shtetëror, granti i performancës mund të mbështetet financiarisht edhe nga donatorët ndërkombëtar.

Ndërsa, nëse aprovohen plotësimet në Ligjin për vetëqeverisje lokale, parashihet të ketë ndryshime të mëdha sa i përket rolit të nënkryetarëve të komunave, shqyrtimit administrativ të akteve, procedurave që qytetarët të inicojnë vendim ose rregullore komunale, si dhe është zgjeruar për një pikë te neni që tregojnë se në cilat raste kuvendi komunal shkon në zgjedhje të jashtëzakonshme.

<sup>1</sup> Zyra e Kryeministrit. Programet legjislative 2021 dhe 2022. Burimi: <https://bit.ly/3A6LYVW> & <https://bit.ly/3OGVDXp>

## Hyrje

Rishikimi i bazës ligjore për funksionimin e pushtetit lokal ka qenë një ndër veprimet e parapara edhe me Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016–2026, e cila ka hyrë në fuqi gjashtë vite më parë. Sipas Strategjisë, rishikimi i bazës ligjore është i domosdoshëm për faktin e sqarimit të kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal sa i përket ofrimit të shërbimeve publike, harmonizimi i legjislacionit me legjislacionin e përbashkët evropian dhe rritja e qëndrueshmërisë buxhetore të komunave. Në një analizë të vitit 2017, Instituti GAP kishte gjetur se nga 19 kompetencat vetanake të komunave sipas nenit 14 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, asnjëra nuk ushtrohet ekskluzivisht nga komunat.<sup>2</sup>

Qeveria Kurti 2 ka filluar ndryshimin e ligjeve kryesore të pushtetit lokal. Dy ligjet bazike të pushtetit lokal, ai për vetëqeverisje lokale dhe për financat e pushtetit lokal, u janë nënshtruar procedurave të plotësim/ndryshimit. Krahas kësaj, në vitin 2021, është hartuar edhe Projektligji për menaxhimin e performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë.

Në periudhën 2021–2022, institucionet kanë plotësuar edhe disa ligje tjera të cilat prekin edhe funksionet e pushtetit lokal, si: Projektligji për prokurim publik, Projektligji për partneritet publiko-privat, Projektligji për rendin dhe qetësinë publike, Projektligji për shërbimet sociale dhe familjare, Projektligji për pronën publike, Projektligji për tokën ndërtimore, Projektligji për zyrtarët publik dhe Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Deri në korrik të vitit 2022, asnjëri nga këto projektligje nuk ka kaluar miratimin e plotë në Kuvendin e Kosovës, përveç Projektligjit për tokën ndërtimore që ka kaluar leximin e parë.

**Ligji për vetëqeverisje lokale** është miratuar në qershor të vitit 2008 dhe që nga ajo kohë nuk i është nënshtruar asnjëherë ndryshimit. Ky ligj bën pjesë në ligjet me interes vital, çka nënkupton që amendamentimi i tij mund të bëhet vetëm edhe me votat e 2/3 të deputetëve që mbajnë vende të garantuara në Kuvendin e Kosovës.

**Ligji për financat e pushtetit lokal** rregullon procedurat e miratimit, shpenzimit dhe menaxhimit buxhetor në komuna. Ky ligj nuk bën pjesë në ligjet me interes vital e për rrjedhojë, në vitin 2016 ka kaluar nëpër disa ndryshime. Në pjesën e parë të vitit 2019, Ministria e Financave kishte nisur procedurat për amendamentimin e sërishëm të këtij ligji. Por, ndryshimet e propozuara nuk kanë arritur të miratohen në Kuvendin e Kosovës. Në prill të vitit 2021 kanë nisur procedurat nga e para për amendamentimin e këtij ligji, i cili në përmbajtjen e tanishme parasheh një numër të madh ndryshimesh, veçmas te pjesa e të hyrave për komuna.

**Projektligji për menaxhimin e performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë** do të zëvendësojë Rregulloren 02/2017 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.<sup>3</sup> Kjo rregullore ka mbuluar çështjen e performancës komunale nga viti 2017, si dhe kriteret e vlerësimit dhe format dhe shumatat e përfitimit për komuna. Me këtë Projektligj, procesi i performancës komunale institucionalizohet (bëhet obligativ për komuna), si dhe shteti merr përsipër ndarjen e një granti të përvitshëm, që do të alokohet në komuna, bazuar në rangimin e tyre sipas performancës.

Kjo analizë vë në pah ndryshimet e propozuara ligjore në fushën e pushtetit lokal nga qeveria Kurti II dhe përfitimet që do t'i mund t'i kenë komunat. Me theks të veçantë janë analizuar tri projektligje, ai i vetëqeverisjes lokale, për financat e pushtetit lokal dhe Projektligji për menaxhimin e performancës komunale dhe grantit të bazuar në performancë.

<sup>2</sup> Instituti GAP. Sa kanë kompetenca vetanake komunat? Prishtinë, 2017. Burimi: <https://bit.ly/2Dy74hM>

<sup>3</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Rregullorja 02/2017 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave. Burimi: <https://bit.ly/3M1ctF>

## 1. Ndryshimet e propozuara në Ligjin për vetëqeverisje lokale

Ligji për vetëqeverisje lokale është ligj bazik i pushtetit lokal në Kosovë. Pas miratimit të tij në vitin 2008, është paraqitur nevoja që ky ligj të amendamentohet në disa pjesë të tij. Nisur nga fakti që ky ligj është me interes vital, çka nënkupton se për amendamentimin e tij kërkohen edhe votat e 2/3 të deputetëve që mbajnë vende të garantuara në Kuvendin e Kosovës, amendamenti është pamundësuar nga refuzimi i deputetëve nga Lista Serbe për ta votuar këtë projektligj, pa veçuar në opinion nga ana e tyre ndonjë arsye ose kërkesë zyrtare.<sup>4</sup> Në periudhat e mëhershme (gjatë vitit 2016–2017), partia që përfaqëson serbët e Kosovës në Kuvend, pati kushtëzuar votën e tyre me formimin edhe të një komune të re në Kosovë atë, të Prelluzhës.<sup>5</sup>

Në prill të vitit 2021, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka krijuar grupin punues për hartimin e amendamenteve të Ligjit për vetëqeverisje lokale.<sup>6</sup>

Në nëntor të vitit 2021, Qeveria e Kosovës ka miratuar këtë projektligj dhe kësisoj, e ka proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.<sup>7</sup> Kuvendi ka miratuar në parim këto ndryshime gjatë muajit shkurt të vitit 2022, por ka dështuar gjatë muajit prill që ta miratojë atë në lexim të dytë, për shkak të mos sigurimit të 2/3 të votave të deputetëve jo shumicë.<sup>8</sup>

Ndryshimet kanë prekur një pjesë të madhe të neneve ekzistuese të këtij ligji. Por, pjesa më e madhe e ndryshimeve të propozuara janë lidhur me sqarime dhe pak nga to kanë të bëjnë me ndryshime rrënjësore të kompetencave dhe përgjegjësisve që aktualisht i gëzojnë komunat nëpërmjet këtij ligji.

Kësisoj, nga 90 nene sa ka gjithsej Ligji për vetëqeverisje lokale, grupi punues ka miratuar 114 komente ose ndërhyrje në 43 nene të Ligjit. Por, vetëm katër amendamente paraqesin ndryshim nga përmbajtja ekzistuese, meqë pjesa tjetër janë sqarime ose plotësime, por që nuk ndryshojnë asgjë nga praktikat e deritanishme.<sup>9</sup>

Ndryshime thelbësore janë paraparë te roli i nënkryetarëve të komunave, shqyrtimi administrativ i akteve, mënyra e nisjes së procedurave nga qytetarët për të inicuar një vendim ose rregullore komunale dhe është shtuar një pikë të neni që tregon se në cilat raste kuvendi komunal konsiderohet jo funksional.

Për rolin e nënkryetarëve, është parashikuar se të njëjtit marrin funksionet e plota të kryetarëve, në rast kur këta të fundit dorëhiqen, vdesin ose shkarkohen 12 muaj para përfundimit zyrtar të mandatit katër vjeçar. Në këto raste, komuna nuk shkon në zgjedhje të jashtëzakonshme, por funksionin e kryetarëve e ushtrojnë nënkryetarët.<sup>10</sup> Në rastet kur edhe pozita e nënkryetarit/es mbetet e lirë, ministria përgjegjëse për pushtet lokal cakton një administrator/e brenda shërbimit civil të komunës deri në zgjedhjen e kryetarit/es.<sup>11</sup>

4 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 81. Legjislati me interes vital. Burimi: <https://bit.ly/3LfRpnC>

5 Gazeta "Zëri". Jevtiq; Plementin – Prelluzhë, komunë e re serbe. 8 tetor, 2017. Burimi: <https://bit.ly/3d98vYI>

6 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Fillon procesin për reformimin e kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale. 06.07.2021. Burimi: <https://bit.ly/3yBbNwN>

7 Zyra e Kryeministrit e Qeverisë së Kosovës. Programi legjislativ për vitin 2021. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Burimi: <https://bit.ly/3yGy8ce>

8 Agjencia "Kosovapress". Kuvendi miraton tri projektligje, deshton ai për qeverisje lokale. 14.04.2022. Burimi: <https://bit.ly/3Pqwdi0>

9 Kuvendi i Kosovës. Projektligjet. Versioni i pranuar nga qeveria. Burimi: <https://bit.ly/3a7j9xX>

10 Projektligji për Vetëqeverisje Lokale. Neni 56. Pika 56.4. Burimi: <https://bit.ly/3a7j9xX>

11 Projektligji për Vetëqeverisje Lokale. Neni 56. Burimi: <https://bit.ly/3a7j9xX>

Por, ndryshimi i rolit të nënkryetarit/es nuk mund të bëhet pa e amendamentuar Ligjin për zgjedhjet lokale, ngase është ky ligj i cili parasheh kohëzgjatjen e mandatit dhe format ose mënyrat se si përfundon mandati i kryetarëve dhe në cilat raste komuna shkon në zgjedhje të parakohshme.<sup>12</sup> Edhe Ligji për zgjedhjet lokale bën pjesë në të ashtuquajturin legjislacion me interes vital. Aktualisht, nuk ka ndonjë nismë në plotësim/ndryshimin e Ligjit për zgjedhjet lokale.

Ndryshim tjetër rrënjësor është paraparë në nenin 70 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, përkatësisht te e drejta e qytetarëve për iniciativa. Në versionin e ligjit që është në fuqi është e saktësuar se qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga kuvendi komunal, në pajtim me ligjin në zbatim. Draft rregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar për t'u shqyrtuar nga kuvendi i komunës. Me plotësim/ndryshimin e këtij ligji është paraparë që qytetarët mund të iniciojnë edhe projekte përveç rregulloreve, dhe se një nismë e tillë duhet të nënshkruhet nga 5% e votuesve të regjistruar.<sup>13</sup>

Me Ligjin aktual për vetëqeverisje lokale, kuvendi komunal është organi më i lartë vendimmarrës. Kjo ka mbetur edhe në versionin e ofruar të plotësim/ndryshimit të këtij ligji, por është zgjeruar lista e arsyeve që e bëjnë kuvendin komunal jo funksional. Pika shtesë ka të bëjë me obligimin që kanë asambleistët komunal për ta krijuar korumin kur kryetarët e komunave kanë për të dhënë betimin në rastet e inagurimit të mandatit. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë kuvendi komunal konsiderohet jo funksional dhe i nënshtrohet Ligjit për zgjedhjet lokale. Kuvendi komunal, po ashtu, konsiderohet jo funksional nëse refuzohet zbatimi i ligjshmërisë së vendimeve të MAPL ose nga organet e tjera relevante, si dhe konsiderohet jo funksional nëse refuzon të zgjedh nënkryetarin/en për komunitete sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale.<sup>14</sup>

Ndryshime janë paraparë edhe në nenin 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Në versionin e projektligjit saktësohet se autoriteti mbikëqyrës (MAPL) obligohet që të japë opinionin për ligjshmërinë e çdo akti të regjistruar komunal, brenda 15 ditëve të punës nga pranimi i lëndës; si dhe lidhur me shqyrtimin administrativ të akteve, MAPL nxjerrë një udhëzim përkatës ligjor. Kjo, në rast se hyn në fuqi e zgjat afatin e përgjigjes nga MAPL nga 15 ditë kalendarike në 15 ditë pune.<sup>15</sup>

## — 2. Ndryshimet e propozuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal

Plotësim/ndryshimi i Ligjit për Financat e pushtetit lokal, është paraparë me programin legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2021.<sup>16</sup> Aty është precizuar që qeveria do t'i miratojë ndryshimet e dala në këtë ligj deri në nëntor të 2021. Projektligji ka dalë në konsultim publik në shtator 2021, por nuk është aprovuar ende nga qeveria.<sup>17</sup>

Ligji për financat e pushtetit lokal është i dyti me i rëndësishmi për komunat e vendit, pas atij për vetëqeverisje lokale. Ky ligj, për dallim nga ai për vetëqeverisje lokale, nuk bën pjesë në mesin e ligjeve me interes vital dhe ndryshimi i tij nuk kërkon shumicën e dyfishtë të votave. Nga koha e miratimit të tij të parë në vitin 2008, ky ligj i është nënshtruar njëherë plotësim/ndryshimit në vitin 2016 dhe kanë nisur procedurat e sërishme për të ndryshuar në vitin 2019, por, për shkak

<sup>12</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Zgjedhjet Lokale. Neni 4. Burimi: <https://bit.ly/39p9vGd>

<sup>13</sup> Projektligji për Vetëqeverisje Lokale. Neni 38. Burimi: <https://bit.ly/3a7j9xX>

<sup>14</sup> Projektligji për Vetëqeverisje Lokale. Neni 33. Burimi: <https://bit.ly/3a7j9xX>

<sup>15</sup> Projektligji për Vetëqeverisje Lokale. Neni 81. Burimi: <https://bit.ly/3a7j9xX>

<sup>16</sup> Zyra e Kryeministrit e Qeverisë së Kosovës. Programi legjislativ për vitin 2021. Ministria e Financave.

Burimi: <https://bit.ly/3yGy8ce>

<sup>17</sup> Platforma e Konsultimit Publik. Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: <https://bit.ly/3wx8Fz8>

të jo stabilitetit politik në vend (ndryshimeve të shpeshta të qeverive në atë periudhë), si dhe përfshirja e vendit nga pandemia, e kanë shtyrë këtë proces, për të nisur nga e para nga prilli i vitit 2021.

Ndryshimet e propozuara në versionin aktual të këtij projektligji janë thelbësore. Komunitetët është paraparë të përfitojnë tri grante shtesë: grant i veçantë për projekte kapitale, granti për çështje sociale dhe granti i jashtëzakonshëm; ndërsa grantet e deritanishme (grantit të përgjithshëm, ai për arsim dhe shëndetësi) nuk do të preken me propozimet e ofruara dhe kriteret do të mbesin të njëjta, por vlera e grantit të përgjithshëm nuk do të jetë më 10% e buxhetit të shtetit, por 9%.<sup>18</sup>

Me Programin e Qeverisë së Kosovës 2021–2025 është paraparë që për komuna të krijohet i ashtuquajti granti i katërt. Por, gjatë fazës së plotësim/ndryshimit të Ligjit për financat e pushtetit lokal, ky grant është emërtuar si grant për projekte kapitale.<sup>19</sup> Në këtë program është paraparë, që ky grant, do t'u mundësojë komunave autonome për investime kapitale, ku do të vendosen kriteret, të cilat u mundësojnë komunave të konkurrojnë me idetë dhe projektet e tyre për zhvillim të gjithanshëm, në sektorë si turizmi rural, inovacioni, sportet, trashëgimia kulturore, arti, infrastruktura publike, sistemet e ngrohjes qendrore, furnizimi me ujë të pijshëm, ripërtëritje e hapësirave të dëmtuara dhe trajtimi i ujërave të zeza. Por, në propozimet e ofruara në Projektligjin për financat e pushtetit lokal, komunitetët nuk është paraparë të garojnë për t'i tërhequr mjetet nga granti për projekte kapitale, por komunave do t'u ndahen këto mjete mbi baza vjetore, llogaritur sipas numrit të popullsisë dhe madhësisë së territorit. Në vitin e parë 20% të vlerës së grantit të përgjithshëm, në vitin e dytë 30% dhe nga viti i tretë jo më pak se 40% e vlerës së grantit të përgjithshëm.

Arsyeja për një grant të kësaj natyre ka ardhur nga nevoja që ministritë e linjës të mos ndajnë buxhet për komuna bazuar në preferenca partiake apo personale. Instituti GAP, për disa vite ka analizuar ndarjet e këtyre mjeteve për komuna, duke konstatuar mungesë kriteresh dhe mungesë investimesh të qëndrueshme nga ministritë të komunave.<sup>20</sup>

Nga buxheti total i ministrive për vitin 2022, rreth 515 milionë euro janë planifikuar në projekte kapitale, e nga të cilat, rreth 97 milionë euro (19%) do të investohen në 33 komuna. Në Ligjin për buxhet nuk jepen shpjegime për kriteret që aplikohen kur vendoset për investimet e nivelit qendror në komuna. Rreth 49.5 milionë euro (51%) të investimeve të ministrive në komuna do të mbulojnë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Si rezultat i vazhdimit të projekteve të mëhershme, në buxhetin për vitin 2022 kishte pak hapësirë për projekte të reja. Mbi 86.8 milionë euro apo 89% e projekteve të ministrive në komuna janë vazhdim i viteve të kaluara, ndërsa rreth 10.3 milionë euro janë projekte të reja. Gjatë vitit 2022, komunitetët të cilat do të përfitojnë më shumë nga investimet e reja janë Prizreni (rreth 1.9 milionë euro), Prishtina (rreth 1.5 milionë euro), Podujeva (rreth 1.2 milionë euro) dhe Gjakova (1 milion euro).<sup>21</sup>

Kriteret, në bazë të propozimeve të bëra në Ligjin për financat e pushtetit lokal, për ndarjen e grantit për projekte kapitale janë përafësisht të njëjta, me kriteret që përdoren edhe për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna.

<sup>18</sup> Ibid

<sup>19</sup> Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Programi i qeverisë 2021–2025. Fq 23. Granti i katërt. Burimi: <https://bit.ly/3Niwi5y>

<sup>20</sup> Instituti GAP. Projektbuxheti 2021: Favorizimet dhe Diskriminimet e Komunave në Investime Kapitale. Burimi: <https://bit.ly/38wvz1B>


<sup>21</sup> Instituti GAP. Ligji për Buxhet 2022: Favorizimet dhe diskriminimet e komunave në investime kapitale. Maj 2022. Fq 1. Burimi: <https://bit.ly/3la9IA4>

Numri i popullsisë dhe madhësia territoriale e komunës, do të jenë dy kriteret e vetme që do të përdoren, gjatë alokimit të këtij granti. Të dy këto kriteret janë edhe pjesë e kriterëve gjatë ndarjes së grantit të përgjithshëm. Ky grant do të ndahet 80% bazuar në numrin e popullsisë dhe 20% bazuar në madhësinë territoriale të komunës.<sup>22</sup>

Por, për dallim nga granti i përgjithshëm, ku komunës i ofrohet autonomi që t'i përcaktojë alokimet buxhetore në kategoritë e caktuara, te granti për projekte kapitale kjo e drejtë nuk ekziston. Granti për projekte kapitale mund të shfrytëzohet vetëm për investime kapitale. Me fillimin e zbatimit të këtij ligji ndalohet financimi dhe/ose bashkëfinancimi i projekteve kapitale në kompetencat komunale nga buxheti i ministrive.<sup>23</sup>

Por, zbatimi i këtij obligimi është paraparë të implementohet në mënyrë graduale. Në vitin e parë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, komunat do të përfitojnë 20%, në vitin e dytë 30%, ndërsa nga viti i tretë minimum 40% të vlerës së grantit të përgjithshëm.<sup>24</sup> Nga kjo, i bie që të gjitha komunat e Kosovës nga granti për projekte kapitale, bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2023–2025, pas tri viteve do të kenë në dispozicion mbi 104 milionë euro në vit.

### Grafikoni 1. Vlera minimum e përfitimit të gjitha komunave nga granti për projekte kapitale për tri vite (2023 -2025)



- Vlera e grantit të përgjithshëm për gjitha komunat (në milion €)
- Vlera e grantit që përfitojnë komunat nga granti për investime kapitale (në milion €)

Burimi: Ministria e Financave. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023–2025. Shuma e grantit të përgjithshëm për gjitha komunat dhe llogaritja e përfitimeve për gjitha komunat bazuar në përqindje e paraparë në Plotësim/ndryshimet e propozuara në Ligjin e financave të pushtetit lokal

Shuma e grantit të përgjithshëm (për të gjitha komunat) sipas propozimeve të vendosura në Projektligjin për financat e pushtetit lokal është 9% e shumës së përgjithshme të buxhetit të shtetit. Vlera 9% mbetet e njëjtë për çdo vit, ndryshon shuma, varësisht nga rritja buxhetore në nivel vendi (minus të hyrat nga kreditë ndërkombëtare dhe nga shitja e pasurive).<sup>25</sup>

22 Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal. Granti për Investime Kapitale. Neni 14. Burimi: <https://bit.ly/3wx8Fz8>

23 Ibid

24 Ibid

25 Ibid



**Tabela 1.** Shuma që parashihet të marrin komunat për vitin 2023–2025 nga granti i përgjithshëm dhe shuma e mjeteve që do të marrin nga granti për projekte kapitale për tri vitet vijuese sipas përqindjes së paraparë në ndryshimin e Ligjit për financat e pushtetit lokal

Komuna	Granti i përgjithshëm për vitin 2023	Granti i përgjithshëm për vitin 2024	Granti i përgjithshëm për vitin 2025	Granti për projekte kapitale – Viti i parë 2023 (20%)	Granti për projekte kapitale -Viti i dytë 2024 (30%)	Granti për projekte kapitale -Viti i tretë 2025 (jo më pak se 40%)
Deçan	5,026,625.43 €	5,386,949.99 €	5,739,429 €	1,076,132.25 €	1,730,388.28 €	2,458,730.91 €
Gjakova	11,883,453.07 €	12,749,260.52 €	13,596,215 €	2,447,408.75 €	3,935,359.62 €	5,591,803.00 €
Drenas	7,042,785.88 €	7,551,922.17 €	8,049,972 €	1,440,873.87 €	2,316,881.83 €	3,292,087.13 €
Gjilan	10,872,861.88 €	11,664,436.60 €	12,438,775 €	2,192,563.42 €	3,525,576.00 €	5,009,536.19 €
Dragash	5,334,661.39 €	5,717,074.63 €	6,091,161 €	1,063,890.52 €	1,710,703.94 €	2,430,761.19 €
Istog	5,300,879.74 €	5,681,209.30 €	6,053,257 €	1,194,280.32 €	1,920,366.82 €	2,728,673.86 €
Kaçanik	4,147,797.21 €	4,443,362.66 €	4,732,492 €	867,999.50 €	1,395,717.07 €	1,983,192.30 €
Klinë	4,915,689.42 €	5,267,788.96 €	5,612,222 €	1,055,713.53 €	1,697,555.59 €	2,412,078.52 €
Fushë Kosovë	4,428,038.54 €	4,744,203.97 €	5,053,485 €	788,862.26 €	1,268,466.77 €	1,802,380.72 €
Kamenicë	4,827,343.62 €	5,172,805.40 €	5,510,745 €	1,102,405.50 €	1,772,634.87 €	2,518,759.64 €
Leposaviq	3,378,310.67 €	3,616,161.33 €	3,848,833 €	739,141.01 €	1,188,516.50 €	1,688,778.35 €
Lipjan	7,208,957.38 €	7,730,179.39 €	8,240,052 €	1,474,124.81 €	2,370,348.33 €	3,368,058.37 €
Obiliq	2,787,987.41 €	2,983,231.77 €	3,174,225 €	533,100.34 €	857,209.30 €	1,218,019.70 €
Rahovec	6,841,551.84 €	7,335,800.40 €	7,819,287 €	1,394,750.82 €	2,242,717.35 €	3,186,705.87 €
Pejë	12,218,374.53 €	13,108,815.97 €	13,979,868 €	2,499,374.78 €	4,018,919.44 €	5,710,534.21 €
Podujevë	10,895,679.02 €	11,688,799.73 €	12,464,651 €	2,360,943.93 €	3,796,326.80 €	5,394,249.47 €
Prishtinë	23,380,893.75 €	25,090,923.88 €	26,763,719 €	4,540,072.07 €	7,300,299.27 €	10,373,088.93 €
Prizren	22,834,779.45 €	24,504,867.90 €	26,138,591 €	4,178,531.25 €	6,718,952.50 €	9,547,045.84 €
Skenderaj	6,309,356.51 €	6,764,290.11 €	7,209,318 €	1,365,145.47 €	2,195,112.84 €	3,119,064.01 €
Shtime	3,421,367.71 €	3,663,358.57 €	3,900,080 €	677,137.16 €	1,088,816.18 €	1,547,112.89 €
Shtërpcë	1,427,756.53 €	1,522,448.61 €	1,615,079 €	352,945.13 €	567,525.16 €	806,403.78 €
Suharekë	7,315,229.65 €	7,844,379.03 €	8,362,006 €	1,537,126.18 €	2,471,652.64 €	3,512,002.96 €
Ferizaj	13,000,772.30 €	13,949,326.05 €	14,877,225 €	2,533,603.22 €	4,073,957.74 €	5,788,738.84 €
Viti	5,756,352.72 €	6,170,557.65 €	6,575,743 €	1,197,943.15 €	1,926,256.53 €	2,737,042.63 €
Vushtrri	8,457,482.97 €	9,070,916.59 €	9,670,993 €	1,733,778.78 €	2,787,864.11 €	3,961,311.90 €
Zubin Potok	1,840,974.58 €	1,965,864.21 €	2,088,034 €	417,733.00 €	671,702.09 €	954,430.12 €
Zvecan	1,700,973.21 €	1,815,686.70 €	1,927,902 €	258,271.84 €	415,293.35 €	590,095.66 €
Malishevë	6,642,527.52 €	7,122,103.19 €	7,591,236 €	1,385,708.18 €	2,228,177.05 €	3,166,045.37 €
Novobërdë	1,348,858.50 €	1,437,764.05 €	1,524,734 €	310,734.03 €	499,650.97 €	709,960.47 €

Komuna	Granti i përgjithshëm për vitin 2023	Granti i përgjithshëm për vitin 2024	Granti i përgjithshëm për vitin 2025	Granti për projekte kapitiale - Viti i parë 2023 (20%)	Granti për projekte kapitiale -Viti i dytë 2024 (30%)	Granti për projekte kapitiale -Viti i tretë 2025 (jo më pak se 40%)
Mitrovicë e Veriut	2,480,184.30 €	2,652,242.03 €	2,820,553 €	259,075.87 €	416,586.20 €	591,932.67 €
Mitrovicë e Jugut	8,746,257.59 €	9,380,960.71 €	10,001,843 €	1,763,932.07 €	2,836,349.68 €	4,030,205.66 €
Junik	913,788.47 €	970,826.73 €	1,026,623 €	188,085.42 €	302,435.70 €	429,734.76 €
Hani i Elezit	1,299,162.05 €	1,384,628.48 €	1,468,234 €	263,959.41 €	424,438.78 €	603,090.51 €
Mamushë	1,221,458.35 €	1,300,956.74 €	1,378,724 €	140,341.22 €	225,664.46 €	320,649.52 €
Graçanicë	2,491,670.78 €	2,664,447.85 €	2,833,463 €	330,646.33 €	531,669.35 €	755,455.80 €
Ranillug	951,047.54 €	1,010,648.63 €	1,068,952 €	137,698.90 €	221,415.69 €	314,612.40 €
Partesh	507,015.01 €	533,988.43 €	560,375 €	61,700.74 €	99,212.93 €	140,972.93 €
Kllokot	530,093.51 €	558,811.08 €	586,903 €	72,064.95 €	115,878.27 €	164,652.91 €
<b>Totali</b>	<b>229,689,000 €</b>	<b>246,222,000 €</b>	<b>262,395,000 €</b>	<b>45,937,800 €</b>	<b>73,866,600 €</b>	<b>104,958,000 €</b>

\* Shuma e grantit të përgjithshëm ndahet bazuar në numrin e popullsisë, madhësinë e territorit, numrin e pakicave që jetojnë në komunat përkatëse si dhe në faktorin e qëndrueshmërisë së komunave. Në këto të dhëna nuk përfshihet granti për kryeqytetin dhe të hyrat nga dividendat për Obiliqin. Ndërsa granti për projekte kapitiale do të ndahet 80% bazuar në numrin e popullsisë dhe 20% bazuar nga madhësia e territorit të seciles komunë.

Në versionin aktual të Projektligjit për financat e pushtetit lokal është paraparë që komunat të kenë në dispozicion edhe një grant tjetër, atë për shërbime sociale.<sup>26</sup> Sipas Projektligjit, granti i veçantë për shërbime sociale përdoret për financimin e kostos së ofrimit të nivelit të standardit minimal të shërbimeve sociale në territorin e komunës. Granti i veçantë për shërbime sociale përcaktohet duke marrë parasysh kriteret në vijim:

1. Numri i qendrave për punë sociale, numri i qendrave rezidenciale dhe numri i qendrave ditore sipas standardeve të përcaktuara nga niveli qendror.
2. Numri i punëtorëve social në përpjestim me numrin e banorëve dhe numrin e rasteve.
3. Numri i fëmijëve në bazë të grup-moshave dhe të rriturve të cënuar apo rrezikuar.
4. Numri i viktimave të dhunes në familje, trafikimit dhe abuzimit.
5. Numri i personave me nevoja të veqanta sipas shkallës së pa-aftësisë.
6. Numri i personave të moshuar mbi moshën 65 vjeç.
7. Numri i familjeve në asistencë sociale në relacion me siperfaqën e territorit komunal.

26 Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal. Granti për Shërbime Sociale. Neni 13. Burimi: <https://bit.ly/3wx8Fz8>

Vlera e grantit për shërbime sociale nuk është përcaktuar me Projektligj, por është precizuar se kjo do të bëhet nëpërmjet një akti nënligjor i cili duhet të miratohet nga Zyra e Kryeministrit.<sup>27</sup>

Me Projektligjin e propozuar, për komuna është paraparë edhe mundësia për t'u alokuar edhe një grant tjetër i quajtur si granti i jashtëzakonshëm. Ky grant nuk alokohet mbi baza vjetore dhe nuk dedikohet për të gjitha komunat dhe po ashtu nuk i nënshtrohet vlerësimit të përvjetshëm të komisionit të granteve. Në rast të situatave të jashtëzakonshme siç mund të jenë fatkeqësitë natyrore apo epidemitë, Qeveria i ndan grant të jashtëzakonshëm komunës me qëllim të ballafaqimit të barrës që shkakton kjo ndodhi në buxhetin e komunës, nëse burimet e komunës janë të pamjaftueshme. Për dhënien e grantit të jashtëzakonshëm, ministria përgjegjëse për financa duhet të pranojë kërkesën nga komuna përkatëse dhe vlerësim nga institucioni përkatës për fatkeqësinë natyrore apo epidemitë, lidhur me shumën përkatëse të grantit të kërkuar, dhe procedimi i mëtutjeshëm zhvillohet sipas legjislacionit për menaxhimin e financave publike.<sup>28</sup>

**Tabela 2.** Të gjitha të hyrat që kanë komunat (Euro)

Të hyrat e komunave	2023	2024	2025
Të hyrat vetanake	98,519,259	102,526,781	106,872,444
Granti i përgjithshëm	229,689,000	246,222,000	262,395,000
Granti për arsim	201,201,039	216,184,204	217,096,457
Granti për shëndetësi	70,531,502	74,058,077	77,760,981
Granti për kryeqytetin	15,310,000	16,410,000	17,490,000
Të hyrat nga Ligji për Obiliqin	5,000,000	5,000,000	5,000,000
Të hyrat nga Ligji për Hoqen e Madhe	25,279		
Të hyrat për qendren historike të Prizrenit dhe Zym të Hasit	44,810		
Granti për performancë		5,052,250	5,295,000
Granti për projekte kapitale	45,937,800	73,866,000	104,958,000
Granti për shërbime sociale	*		
Granti i jashtëzakonshëm	*		
Të hyrat nga pika 1 dhe 31 për komunat e veriut		8,000,000	8,000,000
Të hyrat për teatrot profesionale	903,235		
Të hyrat për qendrat rezidenciale (sociale)	4,236,000	4,655,000	5,040,000

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023–2025 dhe Ligji për Buxhetin e Kosovës 2022.

\*Vlera e të hyrave që do të marrin komunat nga granti për shërbime sociale dhe granti i jashtëzakonshëm nuk janë saktësuar, do të hartohet një akt nënligjor për caktimin e vlerave.

<sup>27</sup> Ibid

<sup>28</sup> Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal. Granti i jashtëzakonshëm. Neni 26. Burimi: <https://bit.ly/3wx8Fz8>

### 3. Përfitimet dhe obligimet komunave nga Ligji për menaxhimin e performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë

Në vitin 2017, MAPL ka nisur procesin e matjes së performancës së komunave, lidhur me nivelin e efikasitetit në ushtrimin e funksioneve që lidhen me kompetenca vetanake. Fillimisht, ky proces ka nisur si pilot projekt, për t'u shndërruar pastaj në një proces të përvitshëm, bazuar në një rregullore të hartuar nga MAPL.<sup>29</sup> Ky proces teknikisht është mbuluar nga ana e kësaj ministrie së bashku me projektin DEMOS<sup>30</sup>, ndërsa financiarisht kanë kontribuar përveç MAPL edhe shtetet si Zvicra, Suedia dhe Norvegjia.<sup>31</sup>

Në të kaluarën, MAPL ka bërë përpjekje që ky proces të përfshihet në kuadër të plotësim/ndryshimit të Ligjit për financat e pushtetit lokal, por kjo është parë e pamundur, nisur nga fakti që ligji për financat e pushtetit lokal, rregullon çështjet e financimit dhe jo ato të performancës. Nisur nga kjo, MAPL, mbështetur edhe nga donatorët, ka filluar të shtyjë opcionin e hartimit të një ligji të veçantë që do të trajtonte dhe rregullonte procesin e vlerësimit dhe menaxhimit të performancës komunale.

Kësisoj, për vitin 2021, MAPL ka përfshirë në agjendën legjislative hartimin dhe procedimin në qeveri të këtij ligji. Në fund të vitit 2021, është miratuar nga ana e Qeverisë<sup>32</sup> dhe ka kaluar në shqyrtim dhe miratim të mëtutjeshëm në Kuvend, i cili ka miratuar këtë ligj në korrik të vitit 2022.<sup>33</sup>

Bazuar në Projektligjin për menaxhimin e performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, nga buxheti i shtetit, do të alokohet çdo vit shuma deri në 2.5% e vlerës së grantit të përgjithshëm që marrin komunat.<sup>34</sup>

Mjetet që marrin komunat, nga granti i performancës, bazohet krejtësisht nga rangimi komunave në performancë dhe mjetet e pranuar nuk mund të shpenzohen në asnjë kategori tjetër, përveç në investime kapitale. Granti për performancë komunale përbën një formë të veçantë të përkrahjes financiare për komunat nga buxheti i Kosovës dhe është i hapur për fondet e tjera të kontributdhënësve apo donatorëve.<sup>35</sup>

Nëntëdhjetë përqind e grantit ndahet në bazë të performancës të secilës komunë, të matur sipas treguesve të grantit të performancës komunale, vërsa 10% e shumës së përgjithshme të grantit të performancës komunale ndahet si shpërblim shtesë për komunat në tri vendet e para me performancën më të mirë. Vendi i parë i merr 5% të shumës totale të grantit të 10%, vendi i dytë i merr 3% të shumës totale të 10%, dhe vendi i tretë merr 2%.<sup>36</sup>

Granti i performancës duhet të shpenzohet brenda vitit fiskal kur është alokuar. Në rast të moshpenzimit të grantit brenda vitit fiskal, pjesa e mbetur e mjeteve trajtohet në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

29 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Rregullorja 02/217 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave. Burimi: <https://bit.ly/3MlctF>

30 DEMOS është shkruetesa e projektit "Decentralisation and Municipal Support" (decentralizimi dhe mbështetje komunave) i cili projekt mbështetet nga fondacioni shtetëror zviceran HELVETAS.

31 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Raporti i performancës komunale për vitin 2020. Fq 4. Burimi: <https://bit.ly/3PhqHz>

32 Zyra e Kryeministrit e Qeverisë së Kosovës. Programi legjislativ për vitin 2021. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Burimi: <https://bit.ly/3yGy8ce>


33 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Njoftim. Burimi: <https://bit.ly/3b4L81M>

34 Kuvendi i Kosovës. Projektligjet e pranuar. Projektligji për menaxhimin e performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë. Neni 27. Burimi: <https://bit.ly/3sE3sV4>

35 Ibid

36 Ibid

## Grafikoni 2. Shuma në EURO e mjeteve që do të përfitojnë komunitat nga buxheti i shtetit bazuar në performancë



Burimi: Deklarata Financiare e dërguar në Kuvendin e Kosovës nga Ministria e Financave lidhur me ndikimin financiar të Ligjit për sistemin e matjes së performancës dhe skemën e grantit të bazuar në performancë për vitin 2022-2024

Projektligji precizon se MAPL është institucion përgjegjës për matjen e performancës komunale. Përveç kësaj, kjo ministri harton aktet nënligjore dhe dokumente të politikave për zbatimin efikas të dispozitave të këtij ligji, si dhe zhvillon kapacitete të mjaftueshme të brendshme dhe komunale, për mbarëvajtjen e procesit të raportimit dhe vlerësimit të performancës.<sup>37</sup>

Projektligji, nxjerr një numër obligimesh edhe për komunitat. Përderisa në rregulloren e MAPL të 2017, procesi i përfshirjes së komunave në vlerësim të performancës ishte jo i detyrueshëm, me Projektligj ky proces bëhet i detyrueshëm.

Në kuadër të këtij obligimi, komunitat kanë përgjegjësi të bashkëpunojnë me MAPL për ndërtimin, zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të matjes së performancës komunale. Komunitat janë të detyruara të caktojnë edhe zyrtarët përgjegjës për komunikim dhe raportim lidhur me procesin e performancës. Projektligji saktëson se kryetarët e komunave janë personat që udhëheqin në nivel të komunës me këtë proces dhe gjitha të dhënat dhe dokumentet që përcillen në MAPL nga komuna, duhet të jenë të nënshkruara nga ana e kryetarit/es të komunës, në të kundërtën, të dhënat ose dokumentet konsiderohen jo të vlefshme.<sup>38</sup>

Gjatë procesit të verifikimit, në rast se vërtetohet se një komunë ka raportuar të dhëna të pasakta në krahasim me dokumentet referuese dhe që rezultojnë në performancë më të lartë, performanca e asaj komune në fushën për të cilën të dhënat janë të pasakta, shpallet e pavlefshme. Në rast se vërtetohet se një komunë ka raportuar qëllimisht të dhëna të pasakta apo fiktive të cilat ndikojnë rritjen e performancës në treguesit e grantit të performancës, e njëjta përjashtohet nga e drejta për të përfituar nga ky grant në vitin e alokimit.<sup>39</sup>

37 Kuvendi i Kosovës. Projektligjet e pranuar. Projektligji për Sistemin e Matjes së Performancës dhe Skemën e Grantit të bazuar në Performancë. Neni 28. Burimi: <https://bit.ly/3sE3sV4>

38 Kuvendi i Kosovës. Projektligjet e pranuar. Projektligji Ligji për Sistemin e Matjes së Performancës dhe Skemën e Grantit të bazuar në Performancë. Neni 10 & 11. Burimi: <https://bit.ly/3sE3sV4>

39 Kuvendi i Kosovës. Projektligjet e pranuar. Projektligji Ligji për Sistemin e Matjes së Performancës dhe Skemën e Grantit të bazuar në Performancë. Neni 12. Burimi: <https://bit.ly/3sE3sV4>

**Tabela 3. Përmbledhje e ndryshimeve të propozuara ligjore për rregullimin e vetëqeverisjes lokale**

Rregullimi aktual	Ndryshimet e propozuara
<b>Ligji për vetëqeverisje lokale</b>	
Nënkryetarët i ndihmojnë kryetarëve në ushtrimin e funksioneve ekzekutive.	Nënkryetari/ja merr funksionet e Kryetarit/es nëse kryetari dorëhiqet, vdes apo shkarkohet 12 muaj para mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta lokale.
Ministria (MAPL) nuk ka rol në përzgjedhjen e stafit nëpër komuna.	Ministria (MAPL) mund të caktojë një administrator në komunë që do t'i ushtrorë funksionet e kryetarit/es të komunës në rastet kur komuna nuk ka as nënkryetar/e për t'i ushtruar funksionet publike në 12 muajt e fundit para mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta lokale.
Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga kuvendi apo me votën e qytetarëve, në pajtim me ligjin në zbatim. Draft rregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar për t'u shqyrtuar nga kuvendi i komunës.	Qytetarët mund të inicojnë edhe projekte përveç rregulloreve, dhe se një nismë e tillë duhet të nënshkruhet nga 5% e votuesve të regjistruar.
Kuvendi i komunës konsiderohet jo funksional nëse: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) nuk e zgjedh kryesuesin/en, tridhjetë (30) ditë pas themelimit;</li> <li>b) nuk miraton statutin e saj brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas themelimit;</li> <li>c) nuk miraton buxhetin sipas afatit të paraparë me ligjin përkatës; ose</li> <li>d) nuk mban mbledhje për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj;</li> </ul>	Pikat shtesë që e konsiderojnë kuvendin komunal jo funksional ka të bëjë me obligimin që kanë asambleistët komunal për ta krijuar korumin kur kryetarët e komunave, për të dhënë betimin në rastet e inagurimit të mandatit. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë kuvendi komunal konsiderohet jo funksional dhe i nënshtrohet Ligjit për zgjedhjet lokale. Kuvendi komunal, poashtu, konsiderohet jo funksional nëse refuzohet zbatimi i ligjshmërisë së vendimeve të MAPL ose nga organet e tjera relevante, si dhe konsiderohet jo funksional nëse refuzon të zgjedh sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale nënkryetarin/en për komunitete
Shqyrtimi administrativ i akteve bëhet 15 ditë nga dita e pranimit të lëndës nga komuna	Shqyrtimi administrativ i akteve bëhet 15 ditë pune nga dita e pranimit të lëndës nga komuna.
<b>Ligji për financat e pushtetit lokal</b>	
Vlera e grantit të përgjithshëm është 10% e buxhetit të shtetit (duke përjashtuar të hyrat nga shitja e pasurive, të hyrat e tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara, dhe të hyrat nga huamarrja).	Vlera e grantit të përgjithshëm është 9% e buxhetit të shtetit (duke përjashtuar të hyrat nga shitja e pasurive, të hyrat e tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara, dhe të hyrat nga huamarrja).
Grantet operative për komuna janë: granti i përgjithshëm, granti specifik për shëndetësi dhe granti specifik për arsim	Grantet operative për komuna janë: granti i përgjithshëm, granti specifik për shëndetësi, granti specifik për arsim, granti për projekte kapitale, granti për shërbime sociale dhe granti i jashtëzakonshëm.
Ligji aktual nuk e ndalon mundësinë që ministritë të parashohin investime kapitale nëpër komuna.	Me propozimet e dala në plotësim/ndryshimin e Ligjit për financat e pushtetit lokal, ministritë nuk mund të planifikojnë dhe as të alokojnë buxhet për investime kapitale nëpër komuna

## Rregullimi aktual

## Ndryshimet e propozuara

Granti për projekte kapitale, ndahet bazuar në formulën 80% nga numri i popullsisë së një komune dhe 20% nga madhësia e territorit të asaj komune. Në vitin e parë, vlera e grantit do të jetë 20% e vlerës së grantit të përgjithshëm apo afro 46 milionë euro për të gjitha komunat. Në vitin e dytë, 30% e vlerës së grantit të përgjithshëm apo afro 74 milionë euro dhe në vitin e tretë, jo më pak se 40% të vlerës së grantit të përgjithshëm apo afro 105 milionë euro për të gjitha komunat.

Granti i veçantë për shërbime sociale përdoret për financimin e kostos së ofrimit të nivelit të standardit minimal të shërbimeve sociale në territorin e komunës dhe bazohet në shtatë kritere.

Në rast të situatave të jashtëzakonshme siç mund të jenë fatkeqësitë natyrore apo epidemitë, Qeveria i ndan grant të jashtëzakonshëm komunës me qëllim të ballafaqimit të barrës që shkakton kjo ndodhi në buxhetin e komunës, nëse burimet e komunës janë të pamjaftueshme.

## Rregullorja aktuale e MAPL

## Ligji për menaxhimin e performancës së komunave dhe skemen e grantit të bazuar në performancë

Granti për performancë komunale përcaktohet me Ligjin vjetor të buxhetit dhe me Kornizen Afatmesme të Shpenzimeve.

Granti për performancë komunale është 2.5% e shumës së grantit të përgjithshëm dhe ndarja e tij është mbi baza vjetore.

Shpërndarja e grantit bëhet duke u nisur nga rangimi i tyre në performancë.

Nëntëdhjetë përqind e grantit ndahet në bazë të performancës të secilës komunë, të matur sipas treguesve të grantit të performancës komunale, ndërsa 10% e shumës së përgjithshme të grantit të performancës komunale ndahet si shpërblim shtesë për komunat në tri vendet e para me performancën më të mirë. Vendi i parë i merr 5% të shumës totale të grantit të 10%, vendi i dytë i merr 3% të shumës totale të 10%, dhe vendi i tretë merr 2%.

Në rastet kur të dhënat janë të pasakta ose jo të plota, komuna nuk vlerësohet me pikë përkatëse në fushën për cilën bëhet vlerësimi, përkatësisht të dhënat janë jo të vlefshme.

Në rast se vërtetohet se një komunë ka raportuar qëllimisht të dhëna të pasakta apo fiktive të cilat ndikojnë rritjen e performancës në treguesit e grantit të performancës, e njëjta përjashtohet nga e drejta për të përfituruar nga ky grant në vitin e alokimit.

## Përfundim

Amandamenti i ligjeve që lidhen me pushtetin lokal në Kosovë ka qenë i nevojshëm. Ky proces i nisur, nëse përmbillet brenda propozimeve të ofruara, do t'i bëjë me efikas komunat dhe do të rrisë ndjeshëm të hyrat e tyre, veçmas në fushën e investimeve kapitale.

Ndryshimet ligjore të nisura në fushën e pushtetit lokal mund të mos kalojnë në Kuvendin e Kosovës, ngase Ligji për vetëqeverisje lokale, si ligj bazik i komunave, bën pjesë në legjislacion me interes vital, për rrjedhojë kërkohet vota e 2/3 të deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë. Në të kaluarën, kjo procedurë ka bërë që të dështojnë edhe disa nisma tjera legjislative, për shkak të mungesës së konsensusit politik në Kuvendin e Kosovës.

Kjo nuk pritet të ndodhë me Ligjin për financat e pushtetit lokal dhe Ligjin për menaxhimin e performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, si ligje të cilat nuk bëjnë pjesë në listën e ligjeve me interes vital.

Me ndryshimet e ofruara në ligjin për financat e pushtetit lokal, komunat përveç të hyrave vetanake, grantit të përgjithshëm, atij për arsim dhe shëndetësi, do t'i kenë edhe tri grante të reja, granti për projekte kapitale, grantin për shërbime sociale dhe grantin e jashtëzakonshëm.

Në vazhdimësi, ministritë e ndryshme, kanë planifikuar dhe alokuar buxhet për komuna, duke u nisur kryesisht në preferenca, qoftë lokale apo partiake. Kjo edhe nga analizat e Institutit GAP është parë e dëmshme dhe ka krijuar pabarazi mes komunave dhe shfrytëzim të fondeve publike në favor të interesave të një ose disa komunave. Me qëllim që kjo të ndalet, është përfshirë në ligjin për financat e pushtetit lokal, granti për projekte kapitale. Ky grant, në vitin e parë do të ndahet 20%, në vitin e dytë 30% dhe në vitin e tretë jo më pak se 40% e vlerës së grantit të përgjithshëm. Kjo nënkupton që komunat, pas nisjes së zbatuarit të këtij granti, do të kenë nga viti i parë, në dispozicion mbi 45 milionë euro, në vitin e dytë mbi 73 milionë euro, ndërsa nga viti i tretë jo më pak se 104 milionë euro. Ky grant do të alokohet te komunat bazuar në dy kritere, numrin e popullsisë dhe madhësinë e territorit.

Procesi i nisur në 2017 për matjen e performancës komunale në ushtrimin e kompetencave vetanake, do të bëhet proces i obligueshëm për komuna dhe njëherazi ky proces do të jetë i rregulluar me ligj të veçantë. Deri tani, ky proces financiarisht është mbuluar nga donatorët ndërkombëtar dhe nga buxheti i MAPL. Me miratimin e ligjit për menaxhimin e performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, buxheti për komuna bazuar në performancë do të ndahet mbi baza vjetore nga buxheti i shtetit dhe vlera do të jetë 2.5% e vlerës së grantit të përgjithshëm, apo mbi 5 milionë euro. Projektligji ka lënë të hapur mundësinë që edhe donatorët ndërkombëtarë të mund të japin kontribut financiar në këtë proces. Por, teknikisht procesi i monitorimit, vlerësimit dhe alokimit të grantit të performancës do të jetë në përgjegjësi të MAPL-së.





Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)

Instituti GAP mbështetet nga:



Rockefeller  
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World

Ky projekt është mbështetur nga



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

